



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 4470/11 Prot.

Tiranë, më 14.062023

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1764/1, datë 31.07.2015.

SHOQËRISË “ALB-STAR” SH.P.K
Sheshi Italia, Arena Center, Pallati Fati, Seksioni D, Kati 5, Tiranë.

Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blokun “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “ALB-STAR” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1764/1, datë 31.07.2015, për mineralin gur gëlqeror, në Objektivin “Shtyllë”, Bashkia Korçë, Qarku Korçë.

Me anë të shkresës Tuaj Nr.88, Prot, datë 18.05.2023, protokolluar në MIE, me Nr. 4470, Prot. datë 22.05.2023, subjekti “ALB-STAR” sh.p.k, ka kërkuar Revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit, Nr. 1764/1, datë 31.07.2015, dhënë për shfrytëzimin e mineralit Gur Gëlqeror, në objektin “Shtyllë”, Bashkia Korçë, Qarku Korçë, për arsye të përfundimit të afatit 3 vjeçar të vlefshmërisë.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 2, gërma “a” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 1764/1, datë 31.07.2015, dhënë për shfrytëzimin e mineralit Gur Gëlqeror, në objektin “Shtyllë”, Bashkia Korçë, Qarku Korçë që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 4, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1764/1, datë 31.07.2015, dhënë për shfrytëzimin e mineralit Gur Gëlqeror, në objektin "Shtyllë", Bashkia Korçë, Qarku Korçë, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

